RAPORT VJETOR 2021

Realizuar nga Administrata e U.P.

Nën kujdesin e Presidentes Znj.Valbona Treska

RAPORT VJETOR 2021

© URDHRI I PSIKOLOGUT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Tabela e lëndës

Përshëndetja e Presidentit.....3

1. Rrugëtimi i institucionit gjatë vitit 2021.....6

2. Organet e Urdhrit të Psikologut dhe aktiviteti i tyre funksional.....21

2.1 Asambleja Kombëtare..... 22

2.2 Këshilli Kombëtar.....23

2.3 Zgjedhjet e Urdhrit të Psikologut.....24

2.4 Komisioni i Gjykimit Disiplinor Profesional.....26

2.5 Komisioni i Edukimit në Vazhdim në Psikologji.....27

2.6 Administrata e Urdhrit të Psikologut.....31

2. Komisione të tjera.....31

2.7.1 Komisioni i Licencimit.....31

2.7.2 Komisioni i Praktikës Profesionale.....32

2.8 Koordinatorët Lokal.....34

3. Anëtarësia e Urdhrit të Psikologut.....37

3.1 Psikologë të licencuar.....37

4. Rruga drejt provimit të parë të shtetit për profesionin e psikologut……..... 39

5. Buxheti.....40

5.1 Te ardhurat..... 40

5.2 Shpenzimet..... 40

6. Objektivat e realizuar gjatë vitit 2021.....43

7. Objektivat për vitin 2022..... 44

PËRSHËNDETJA E PRESIDENTIT

(Dr.Valbona Treska - Presidente)

Të nderuar kolegë e miq,

Është kënaqësi që për të pestin vit rradhazi të ndajmë së bashku rrugëtimin e Urdhrit të Psikologut gjatë vitit 2021.

Ky vit, në vazhdën e një viti pandemik, nuk ka qenë i lehtë në realizimin e objektivave, pasi shumë aktivitete dhe punë të planifikuara gjatë këtij viti na është dashur t'i spostojmë në kohë. Gjithsesi ka qenë një vit me sfida dhe me arritje, ndër të cilat realizimi i zgjedhjeve për organet drejtuese të U.P., ka qenë një ndër sfidat dhe arritjet më të mëdha për nga pjesëmarrja e psikologëve dhe dëshira për të vijuar të konsolidojmë institucionin edhe pse nën kushte të vështira pandemie.

Urdhri i Psikologut është tashmë një institucion me struktura të plota që mirëfunksionon në dobi të anëtarësisë. Komisionet tona të licencimit, edukimit në vazhdim, praktikës profesionale apo etikës, kanë vijuar punën dhe kanë marrë në shqyrtim me dhjetra kërkesa.

Ndërkohë që, administrata e U.P. ka vijuar punën me një volum korrespondencash dhe dokumentacioni i cili shtohet vit pas viti, por edhe mirëstrukturohet në vazhdimësi.

Anëtarësia jonë është rritur gjatë këtij viti. Nëse në fillim të funksionimit të institucionit vetë psikologët e patën të vështirë të përshtateshin me rregullat e reja dhe procedurat që duhet të ndiqnin, tashmë konstatohet se jo vetëm anëtarësia, por edhe psikologët e rinj që duan të bëhen pjesë e U.P., kanë më shumë informacion mbi procedurat që duhet të ndjekin. Ndihmë në këtë aspekt vlerësohet të kenë qenë edhe takimet online të realizuar gjatë këtij viti me studentë të universiteteve publike dhe jopublike në vend, me qëllim dhënien e informacionit mbi procedurat e anëtarësimit.

Komisioni i edukimit në vazhdim ka bërë një punë voluminoze gjatë këtij viti me akreditimin e trajnimeve me ofrues të institucioneve të ndryshme dhe organizatave. Janë realizuar në tërësi 9 mbledhje të këtij komisioni gjatë këtij viti dhe në çdo mbledhje ka patur një rend dite me 5 deri në 10 apo më shumë pika për akreditim programesh dhe miratim kreditesh. Risi e këtij viti ka qenë shtimi i akreditimit të programeve nga institucionet publike për trajnimin e psikologëve, kryesisht nga Drejtoritë Rajonale Arsimore Parauniversitare në vend dhe Qendra Shëndetësore Universitare "Nënë Tereza". Drejtuesit e këtyre institucioneve, por edhe vetë psikologët, janë nxitur të realizojnë programe në kuandër të edukimit në vazhdim, pasi edhe kostoja monetare për çdo psikolog pjesëmarrës në këto programe në institucionet publike, është më e ulët dhe ndihmon anëtarësinë. Gjatë këtij viti hapëm edhe thirrjen e parë për shqyrtimin e dokumentacionit për aktivitetet me vetëraportim. Ka qenë një punë e vështirë dhe na mbetet akoma shumë për të bërë në këtë drejtim,

pasi është një proces i ri si për vetë anëtarësinë, ashtu edhe për Komisionin e Edukimit në Vazhdim që ka shqyrtuar këto dosje. Pjesëmarrja në trajnime, konferenca, botime shkencore e të tjera aktivitete të Edukimit në Vazhdim mbetet një ndër sfidat tona edhe për vitin në vijim, me qëllim rritjen e cilësisë së aktiviteteve që akreditohen, por edhe mirëinformimin e çdo psikologu rreth Rregullores së Edukimit në Vazhdim dhe procedurave që duhet të ndjekë për rilicencim.

Një ndër komisionet e rëndësishëm të ruajtjes së standardeve profesionale, ka qenë edhe Komisioni i Etikës dhe Gjykimit Disiplinor Profesional. Vijojmë të kemi numrin më të lartë të ankesave që paraqiten pranë këtij komisioni nga fusha e psikologëve ligjorë. Ka patur disa ankesa edhe nga disa fusha të tjera kompetencash, por vlerësohet se fusha ligjore vijon të jetë shumë sensibël për qytetarët. Për shkak të problematikave që janë ndeshur, po vlerësohet mundësia e ndërmarrjes së politikave specifike për këtë kategori psikologesh gjatë vitit në vijim.

Një pjesë e konsiderueshme e çështjeve të shqyrtuara nga ky komision kanë paraqitur ankesë në Këshillin Kombëtar bazuar në rregulloren përkatëse. Ky organ rast pas rasti ka lënë në fuqi vendimet e Komisionit të Etikës, por ka patur raste kur ka vlerësuar të nevojshme dhe ndryshimin e masave të marra.

Ajo ç'ka konstatohet gjatë këtij viti është një njohje me e mirë e psikologëve me Kodin e Etikës, por gjithsesi fuqizimi i tij dhe rritja e standardeve profesionale, mbeten sfidat kryesore të stukturave të Urdhrit të Psikologut.

Ne kemi vijuar punën gjatë këtij viti me një sërë korrespondencash në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Pozitat e U.P. janë fuqizuar, ç'ka do të thotë se ka gjithashtu një qasje më të mirë ndaj profesionit të psikologut në tërësi në vend.

Një ndër arritjet tona gjatë këtij viti ka qenë prezantimi i manualit "Psikologu në Polici" një bashkëpunim disa mujor mes Programit "Pameca V", Policisë së Shtetit dhe Urdhrit të Psikologut. Kam qenë e nderuar që bashkë me dy kolegë Prof. Dr.Fatbardha Osmanaga dhe Dr.Skerdi Zahaj kemi punuar për finalizimin e këtij manuali dhe botimin e tij. Për herë të parë psikologët në strukturat e Policisë së Shtetit, por edhe vetë këto struktura, kanë një material të plotë për punën që duhet të realizojë çdo psikolog pjesë e organigramës së policisë. Ky manual i hap gjithashtu rrugën rishikimit të planeve të punës për psikologët në polici, plane pune të cilat duhet të jenë në përputhje edhe me standardet dhe direktivat ndërkombëtare.

Edhe pse shumë aktivitete janë mbajtur online, gjatë këtij viti kemi patur një punë intensive në rang ndërkombëtar. Ka patur disa trajnime dhe seminare të organizuara nga Federata Europiane e Psikologëve (EFPA) të cilat janë ofruar falas për anëtarësinë. Po kështu kemi marrë pjesë në çdo mbledhje të Këshillit Ekzekutiv të EFPA-s.

Kemi vijuar të jemi pjesë aktive e Alencës Globale të Psikologëve "Global Psychology Alliance" nën drejtimin e Shoqatës së Psikologëve Amerikanë, (APA). Duke qenë pjesë e këtij grupimi të madh të të gjithë psikologëve në botë, ka bërë që jo vetëm të shkëmbejmë eksperiencat, por të jemi njëkohësisht pjesë e politikave globale të ndërmarra bashkërisht për çështje të caktuara që janë në fokus të psikologëve. Ngrohja globale është një ndër çështjet mbi të cilën po punojmë jo vetëm në rang kombëtar për të ndërmarrë politika parandaluese për dëmtimin e ambientit, por edhe në rang botëror.

Puna e jashtëzakonshme që kemi bërë në 4 vite të institucionit, shërbeu gjatë këtij viti si një shembull motivimi për mbarë shoqatat dhe urdhrat në nivel global. Me kërkesë të Shoqatës së Psikologëve Amerikanë (APA) isha e ftuar të merrja pjesë në punimet e Kongresit të 32-të Ndërkombëtarë të Psikologjisë, i cili i zhvilloi punimet në korrik të këtij viti. Ishte kënaqësi dhe njëkohësisht nder të prezentoja punën e Urdhrit të Psikologut në një panel me CEO-n e APA-s Z.Arthur C. Evans. Prezantimi i Shqipërisë u bë në kuadër të lidershipit të suksesshëm, duke bërë një përshkrim të rrugëtimit të istitucionit të Urdhrit të Psikologut që prej krijimit të tij, sfidave, vështirësive që kemi kaluar si dhe sukseseve që patëm në një periudhë shumë të shkurtër kohore. Këto suksese kulmuan me anëtarësimin me të drejta të plota në Shoqatën Europiane të Psikologëve (EFPA) në korrik 2019 si dhe firmosjen e Memorandumit të Bashkëpunimit me Shoqatën e Psikologëve Amerikanë (APA) në korrik 2020.

Kemi përfunduar regjistrimin e prezantimit për Kongresin e 32-të Ndërkombëtarë në orën 02.00 të

Blv. Gjergj Fishta, Ndërtesa nr. 26, Kati II, Ap.9,Tiranë,
e-mail: sekretaria@urdhriipsikologut.al, Tel.: 0035542209927

mëngjesit nën emocione të forta dhe shumë lumturi për këtë arritje, së bashku me stafin e U.P., që është gjithmonë aty në çdo sfidë pozitive apo negative që kalojmë.

Personalisht pjesëmarrja në këtë Kongres ka qenë një përgjëgjësi e jashtëzakonshme!

Nuk mund të lë pa përmendur gjatë këtij viti një ndër sfidat e mëdha, atë të zgjedhjeve për organet drejtuese të U.P. mbajtur më 27 Mars 2021. Ndërkohë që afronte koha e zgjedhjeve edhe pse në kohë pandemie dhe me vështirësi të grumbullimit të njerëzve në ambiente të brendshme, nisëm udhëtimin në qytetet kryesore të Shqipërisë, me qëllim sensibilizimin e anëtërësisë për pjesëmarrje, paraqitjen e kandidatëve, por edhe me qëllim diskutimin ballë për ballë të problematikave të ndeshura dhe objektivave që na duhet të gjithë së bashku të realizojmë.

Pas një periudhe disa mujore përgatitjesh nën një organizim shembull me komisione votimi, vëzhgues, numërues, staf mbështetës, arritëm të kishim një pjesëmarrje rekord prej 420 anëtarësh, të cilët me votën e tyre vendosën drejtimin e Urdhrit në katër vitet e ardhshme. Jam e nderuar, por njëkohësisht akoma më shumë e motivuar për të punuar dhe vijuar të drejtoj Urdhrin e Psikologut. Përgjegjësitë e mia në këtë mandat të dytë janë padyshim më të mëdha, për të rritur standardet e profesionit tonë dhe për të fuqizuar rolin e psikologut në çdo cep të Shqipërisë. Kam bindjen e plotë se edhe kolegët e nderuar të Këshillit Kombëtar të dalë nga këto zgjedhje, do të bëjnë më të mirën për të shtyrë edhe më tej dhe për të përmirësuar punën e institucionit.

Realizimi i Asamblesë së V-të Kombëtare të U.P. e cila u mbajt në Tiranë në datë 18 qershor 2021 në ambientet e jashtme të Pallatit të Brigadave, ishte gjithashtu një event profesional që vijon të tregojë sa shumë vullnet ka çdo njëri prej nesh anëtarë të Urdhrit të konsolidojmë institucionin, të diskutojmë, të rrahim mendime dhe të gjejmë zgjidhje të përbashkëta në të mirë të profesionit.

Një punë shumë e kujdesshme është bërë gjatë këtij viti në përzgjedhjen e koordinatorëve lokalë, jo vetëm në qarqe që kanë patur gjatë këtyre viteve koordinatorë, por duke shtuar në hartën e tyre edhe qarqe të reja si Vlora, Lushja, Dibra, Gjirokastra dhe Elbasani.

Më lejoni të falenderoj në emrin Tuaj, të gjithë ata psikologë që kandiduan për të qenë koordinatorë lokalë të qarkut të tyre. Dëshira për t'ju bashkuar vullnetarisht strukturave të U.P. dhe për të dhënë ndihmën e tyre, na mbush të gjithëve me optimizëm për konsolidimin e profesionit tonë në çdo skaj të vendit. Jam e lumtur që i gjithë rrjeti ynë i koordinatorëve lokalë në qarqet Vlorë, Gjirokastër, Korçë, Lushnje, Elbasan, Lezhë, Shkodër, Dibër është i ngritur me vajza dhe gra profesioniste dhe të përkushtuara për të qenë ndihmë në komunitet e tyre.

Ne kemi vazhduar të rritemi të gjithë së bashku këtë vit. Në emër të Urdhrit të Psikologut shpreh falenderimin për çdo njërin prej Jush, anëtarë të U.P. që me punën e përditëshme, me dashuri, përkushtim dhe entuziazëm punoni e luftoni çdo ditë, që psikologu të mirëpozicionohet në shoqëri. Çdo njëri prej Jush ka ndihmuar të jemi sot më të fortë profesionalisht dhe me më shumë kërkesa nga qytetarët për të marrë shërbimet tona.

Një vit edhe me më shumë sfida na pret, por jam e sigurt që të gjithë bashkë do të mund të ecim përpara me sukses dhe dinjitet, duke përfaqësuar më së miri emrin PSIKOLOG!

Përzemërsisht,
Valbona Treska

Tiranë, Shqipëri, Janar 2021

1. RRUGËTIMI I INSTITUCIONIT GJATË VITIT 2021

Ndonëse ende nën një vit pandemik për shkak të COVID-19 dhe me shumë sfida për të realizuar aktivitetin tonë të përditshëm, kemi arritur që edhe gjatë këtij viti të kemi një sërë aktivitetesh të suksesshme muaj pas muaji.

Janar

Në datë 26 Janar nëpërmjet një MEMO-je të ardhur nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA), u njoftuam për nisjen e procedurave të zhvillimit të Provimit të Shtetit për herë të parë për psikologët. Kemi bërë një rrugë të gjatë, por një punë shumë të mirë për të mundësuar zhvillimin e provimit të parë të shtetit për psikologët.

Po kështu në sajë të bashkëpunimit ndërmjet Urdhrit të Psikologut dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në fillim të vitit u përmbyllën procedurat për rreth 204 psikologë të rinj që ju shtuan sektorit psiko-social në të gjithë Shqipërinë.

Në datë 27 janar festuam 4 vjetorin e themelimit të Urdhrit të Psikologut. Katër vite punë që nga Asambleja Themeluese! Katër vite histori suksesi!

Në këtë muaj nisi punë edhe grupi i punës, i përbërë nga 9 profesionistë të fushës së psikologjisë, të përzgjedhur nga QSHA, për hartimin e fondit të pyetjeve për Provimin e Shtetit për herë të parë për psikologët.

Urdhri i Psikologut zhvilloi këtë muaj një takim të karakterit informues, në formatin pyetje-përgjigje, ku qëllimi kryesor ishte sqarimi i çdo paqartësie, pyetje dhe problematike të hasur gjatë marrjes pjesë në aktivitetet e akredituara, lidhur me procesin e Edukimit në Vazhdim.

Shkurt

Gjatë muajit shkurt realizuam një takim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve me vullnetin e përbashkët për të fuqizuar dhe konsoliduar rolin e psikologut në sistemin penitenciar.

Blv. Gjergj Fishta, Ndërtesa nr. 26, Kati II, Ap.9,Tiranë,
e-mail: sekretaria@urdhriipsikologut.al, Tel.: 0035542209927

Në datë 19 Shkurt nisi procesi i shpërndarjes së Kartave të Anëtarësisë 2021 për të gjithë anëtarët e Urdhrit të Psikologut.

Urdhri i Psikologut ka nisur prej disa kohësh një seri kontaktesh me kompanitë më të mëdha në treg, me qëllim lehtësimin e shërbimeve në vlerë monetare për psikologët anëtarë të U.P.

Pasi lehtësuam shërbimet me Postën Shqiptare, u realizua këtë vit një tjetër marrëveshje bashkëpunimi, këtë herë me laboratorin më të madh të analizave në vend "INTERMEDICA".

Në këto kohë të vështira, reduktimi i kostove në shërbimet laboratorike që shkojnë nga 5% deri në minus 30% të vlerës së shërbimit, janë një ndihmesë e madhe për komunitetin tonë

Marrëveshja u firmos nga Administratori i "Intermedica" Z.Vasil Llajo dhe Presidentja Znj. Valbona Treska.

Kartat e vlefshme të anëtarësisë të pajisura me kodin QR, tashmë do të shërbejnë edhe për identifikimin e psikologëve anëtarë të U.P. në të gjitha filialet e "Intermedica" në mënyrë që të përfitojnë nga uljet e dakordësuara.

Mars

Gjatë këtij muaji u realizuan takime të Presidentes se Urdhrit të Psikologut Znj.Valbona Treska me anëtarët e Urdhrit të Psikologut në qarqet: Durrës, Shkodër, Berat, Lezhë, Vlorë dhe Elbasan. Këto takime patën për qëllim, informimin e anëtarëve të Urdhrit të Psikologut në lidhje me zgjedhjet për organet drejtuese, prezantimin e kandidatëve, ecurinë e punës së institucionit, për të dëgjuar të gjitha

shqetësimet dhe problematikat e hasura gjatë punës së psikologëve, si dhe për t'Ju përgjigjur çdo pyetje që anëtarët kishin.

Në datë 27.03.2021, u mbajtën zgjedhjet për organet drejtuese të Urdhrit të Psikologut. Me miratimin e Rregullores së Zgjedhjeve të Urdhrit nga ana e Këshillit

Kombëtar të Urdhrit të Psikologut, me vendimin nr.2, datë 03.02.2021, është administrata e Urdhrit të Psikologut, organi përgjegjës për organizimin dhe

mbarëvajtjen e zgjedhjeve për organet drejtuese të Urdhrit të Psikologut. Këto zgjedhje u zhvilluan në ambientet e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, në një ambient që garantoi zbatimin me korrektësi të masave e protokolleve anti COVID-19. Në këto zgjedhje morën pjesë 420 psikologë, anëtarë të Urdhrit të Psikologut nga i gjithë vendi. Një informacion më të zgjeruar mbi këtë proces e gjeni në vijim të këtij raporti.

Blv. Gjergj Fishta, Ndërtesa nr. 26, Kati II, Ap.9,Tiranë,
e-mail: sekretaria@urdhriipsikologut.al, Tel.: 0035542209927

Gjithashtu në këtë muaj zhvilluam një takim me Koordinatorët për sektorin e Shërbimeve Psiko-Sociale të DRAP-eve në vend, si dhe me Znj.Rezarta Basha, përfaqësuese e Shërbimit Psiko-Social në Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe njëkohësisht anëtare e Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut.

Në fokus të këtij takimi ishin diskutime lidhur me vijimin e hapave të përbashkët për zgjidhjen e problematikave të psikologëve të shkollave, të tilla si:

1. Bashkëpunimi ndërmjet DRAP-eve dhe Urdhrit të Psikologut për hartimin dhe implementimin e Rregullores së Brendshme për punonjësit e Shërbimit Psiko-Social, e cila pritet t'i vihet në dispozicion shërbimit brenda muajit mars.
2. Ngritja e një grupi pune, për hartimin dhe unifikimin e Protokolleve të Punës për të gjithë psikologët, pjesë e Shërbimit Psiko-Social.
3. Fillimin e trajnimit online në ditët në vazhdim me të gjithë psikologët shkollorë, pjesë të këtij shërbimi në vendin tonë, mbi Kodin e Etikës dhe Deontologjisë së Psikologut.
4. Hartimin e një kërkese të përbashkët, drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, lidhur me problematikat e rritjes së pagave dhe rimbursimit të transportit për këtë kategori psikologësh.
5. Fillimin e punës për hartimin e programeve të akredituara nga U.P. për marrjen e krediteve nga psikologët e shkollave. (Në rast të aktiviteteve të akredituara të ndërmarra nga institucionet publike, sic është në këtë rast MASR shpenzimet e psikologëve janë në masën vetëm 200 lekë për kredit, pra për një trajnim të akredituar me psh. 5 kredite, vlera e trajnimit është vetëm 1000 lekë).

Prill

Presidentja Znj.Valbona Treska gjatë këtij muaji realizoi një takim me grupin e pedagogëve që do të hartojnë fondin e pyetjeve.

Ka vijuar puna e përditëshme e administratës së U.P. me korrespondenca të vazhdueshme lidhur me problematika që hasin psikologët dhe politika që institucioni po ndjek.

Ka vijuar puna me komisionet e ndryshme pranë U.P.

Maj

Presidentja e Urdhrit të Psikologut Znj.Valbona Treska, zhvilloi gjatë këtij muaji një takim dypalësh me Drejtorin/Rektorin e Akademisë së Sigurisë së Policisë së Shtetit Z.Bilbil Memaj. Institucioni ynë vlerëson maksimalisht Z.Memaj për vullnetin dhe dëshirën për t'i dhënë zë fushës së psikologjisë në polici.

Bazuar në Urdhrin e Përbashkët të Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u zhvillua

Vlerësimi i Aftësimit Praktik në datat 17-18-19-20-21 maj 2021, pranë ambienteve të Urdhrit të Psikologut.

Në listën e provimit ishin 103 praktikantë, prej të cilëve 3 praktikantë nuk u paraqitën ditën e provimit.

Bazuar në Nenin 19, pika 1 dhe pika 2, 99 praktikantë rezultuan kalueshëm dhe vetëm 1 praktikant nuk mundi të kalojë provimin e praktikës.

Gjatë këtij muaji u realizua takimi i Presidentëve të Federatës Europiane të Psikologjisë në platformën Zoom. Ky takim i parapriu Asamblesë së Përgjithshme të EFPA-s që u zhvillua në 29 Qershor 2021.

Shqipëria u përfaqësua në këtë Asamble nga 2 delegatë me të drejtë të plotë vote.

Patëm kënaqësinë gjatë këtij muaji të kishim në zyrat tona, studentë dhe pedagogë të psikologjisë të Univesitetit "Marin Barleti", të cilët u informuan mbi procedurat e regjistrimit dhe licencimit.

Në datë 05.05.2021 u mbajt ceremonia simbolike pranë zyrës së Urdhrit të Psikologut, për të uruar

mirëseardhjen për anëtarët e rinj të zgjedhur në Këshillin Kombëtar. Prezent ishin edhe anëtarët e Këshillit të Parë Kombëtar të Urdhrit të Psikologut, për të cilët u shpërnda nga ana e Urdhrit të Psikologut

Blv. Gjergj Fishta, Ndërtesa nr. 26, Kati II, Ap.9,Tiranë,
e-mail: sekretaria@urdhriipsikologut.al, Tel.: 0035542209927

një çmim mirënjohjeje për kontributin e tyre të çmuar në 4 vitet e para të ekzistencës së institucionit.

Qershor

Urdhri i Psikologut ishte i pranishëm në takimin me temë "Drejtësia Miqësore për të Miturit", aktivitet i organizuar nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, i zhvilluar në Institutin e të Miturve në Kavajë.

Në datë 29.06.2021 u zhvillua online Asambleja e Federatës Europiane të Psikologëve, e cila ishte parashikuar për t'u zhvilluar fizikisht në Lubjanë.

Në këtë muaj mbërriti në zyrën tonë shkresa "Kthim Përgjigje" e ardhur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit "Mbi shqetësimin e psikologëve shkollorë për angazhimin e tyre në administrimin dhe monitorimin e procesit të zhvillimit të Maturës Shtetërore 21". Në këtë shkresë na u sqarua se përfshirja e punonjësve psikologë në administrimin dhe monitorimin e procesit të zhvillimit të Maturës Shtetërore është bërë kryesisht lidhur me kompetencat dhe detyrat që ato kanë, duke shoqëruar nxënës me aftësi të kufizuara. Angazhimi i tyre në këtë proces është bërë me miratimin e këtyre punonjësve. Në të ardhmen Ministria e Arsimit dhe Sportit theksoi se do të garantojë mospërfshirjen më në të tilla procese të punonjësve psikologë, përveç rasteve kur prania e tyre është e domosdoshme.

Me kërkesë të Shoqatës Amerikane të Psikologëve (APA), Presidentja e Urdhrit të Psikologut Znj.Valbona Treska, u ftua të marrë pjesë në punimet e Kongresit të 32-të Ndërkombëtar të Psikologjisë. Ajo u ftua të prezantojë në një panel me Presidenten e Shoqatës së Psikologëve Amerikanë Znj.Jennifer F. Kelly dhe CEO e APA-s Z.Arthur C. Evans. Kemi mbyllur në orët e para të mëngjesit të datës 22 qershor regjistrimin e prezantimit të Shqipërisë në arenën globale.

Në këtë Kongres, i zhvilluar në 22.06.2021 Presidentja Treska referoi mbi lidershipin e

suksesshëm. Ajo bëri një përshkrim të të gjithë rrugëtimit të institucionit të Urdhrit të Psikologut, që prej krijimit të tij e deri më tani, të gjitha sfidave dhe vështirësive që kemi kaluar, por sigurisht edhe sukseseve të arritura në një periudhë kohore kaq të shkurtër, të cilat kulmuan me anëtarësimin me të drejta të plota në Shoqatën Europiane të Psikologëve (EFPA), si dhe me firmosjen e Memorandumit të Bashkëpunimit me Shoqatën Amerikane të Psikologëve (APA).

Në datë 29.06.2021 Urdhri i Psikologut njoftoi se do të zhvillonte një fushatë inspektimi në institucione publike e private për zbatimin e Ligjit 40/2016 *"Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë"*, për të konstatuar çdo shkelje të ligjit nga psikologë të cilët ushtrojnë profesionin pa përmbushur kriteret ligjore.

Korrik

Nisi në muajin korrik inspektimi në terren për evidentimin e rasteve të ushtrimit të profesionit të psikologut në kundërshtim me Ligjin 40/2016 "Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë". Kushdo që u konstatua se ishte në shkelje të ushtrimit të profesionit, pra që nuk përmbushte kriteret e vendosura me ligj, u vu në dijeni nga grupi

i inspektimit dhe i'u la detyrë që brenda një afati 7 ditor, të bënte të mundur që punonjësit psikologë, të plotësonin të gjitha kriteret, duke depozituar pranë Urdhrit të Psikologut të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për t'u bërë anëtarë të Urdhrit.

Në këtë muaj u zhvillua takimi i vendeve anëtare të Shoqatës Europiane të Psikologëve të Punës dhe Organizacional (EAWOP) online.

Që prej majit 2019 jemi anëtarë të EAWOP me të drejta të plota. Për të dytin vit rradhazi, Urdhri i Psikologut i përfaqësuar nga Presidentja u përzgjodh si ekzaminues i raporteve dhe dokumentave të EAWOP për vitin 2020.

Gusht

Presidentja e U.P., Dr.Valbona Treska ishte e ftuar nga Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Gjirokastër, për të folur mbi "Psikologjinë e individit në periudhën e komunizmit".

Blv. Gjergj Fishta, Ndërtesa nr. 26, Kati II, Ap.9,Tiranë,
e-mail: sekretaria@urdhriipsikologut.al, Tel.: 0035542209927



Aktiviteti u mbajt në ambjentet e Kalasë së Argjirosë.

Ky takim mblodhi bashkë jo vetëm profesionistë të fushës, por edhe qytetarë gjirokastritë, që diskutuan mbi ato ç'ka trashëguam nga ajo periudhë dhe mënyrën e funksionimit të shoqërisë, duke mos e

lënë individin të lirë të zhvillohej individualisht dhe profesionalisht.

Aktiviteti u mbyll me një shfaqje nga aktori Arben Derhemi.

U zhvilluan punimet e Kongresit të përvitshëm të "American Psychological Association", nga data 12-15 Gusht 2021. Punimet e këtij Kongresi Presidentja Znj.Treska i ndoqi së bashku me katër kolegë të U.P., të përkushtuar në vite ndaj psikologjisë në vend, siç janë Znj.Elona Mustafaraj, Znj.Blerta Bodianku, Znj. Valbona Habili dhe Z.Arjet Pervizi.

Shtator

Në 7 shtator 2021, pjesëmarrësit e Kongresit të përvitshëm të "American Psychological Association", si përfaqësues të Urdhrit të Psikologut, zhvilluan një takim me anëtarësinë, për të ndarë me ta pikërisht këtë eksperiencë shumë të vyer.



Urdhri i Psikologut përgjatë muajit shtator ka lancuar një kalendar takimesh online me anëtarët, mbi tema të caktuara profesionale, në kuadër të rritjes profesionale.

Qëllimi ishte përmirësimi i ushtrimit të profesionit, rritja e cilësisë së shërbimit dhe profesionalizmit.

Temat e para që u trajtuan në këto takime ishin: "Etika e psikologut në rrjetet sociale", "Ushtrimi i profesionit brenda fushës së kompetencës" dhe "Konsultat dhe terapitë online. Vështirësitë dhe sfidat".

Çdo takim pati një psikolog profesionist që lektoi për pak minuta e moderoi takimin në vazhdim. Më pas u ngritën diskutime, pyetje dhe propozime nga pjesëmarrësit.

Në datë 28 Shtator 2021 pas një kohe shumë të gjatë përfundoi puna për përcaktimin e programit mbi

të cilin do të hartohet fondi i pyetjeve për Provimin e Shtetit për profesionin e psikologut. Urdhri i Psikologut mbetet në pritje të publikimit të Fondit të Pyetjeve nga ana e grupit të punës pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore, në mënyrë që të ndizet drita jeshile për kryerjen e Provimit të Shtetit për herë të parë në vendin tonë.

Tetor

Në këtë muaj u realizua nga Prof. Artemisi Shehu Dono leksioni i rradhës me temë: "Etika e psikologut në rrjetet sociale".

U realizua takim pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ndërmjet Ministres Znj. Ogerta Manastirliu dhe Presidentes së Urdhrit të Psikologut Znj.Treska. Në këtë takim u diskutua lidhur me raportin e ngushtë të bashkëpunimit 4-vjeçar ndërmjet insitucioneve, mbi ecurinë e punës së insitucionit tonë, si dhe sfidat për të ardhmen. Në këtë takim përcollëm të gjitha shqetësimet që na vijnë nga psikologët, të cilët e ushtrojnë profesionin, pranë institucioneve shëndetësore.

Urdhri i Psikologut njoftoi hapjen e aplikimeve për të gjithë ata psikologë, të cilët dëshirojnë të bëhen pjesë e grupeve të punës për hartimin e protokolleve të punës në Arsim, Drejtësi dhe në Shëndetësi.

Në një aktivitet që mori vëmendjen e shumë mediave në vend, konkretizuam një punë mjaft të mirë të bërë në bashkëpunim me Policinë e Shtetit

dhe Pameca V, mbi mirëfunksionimin dhe rolin e psikologut në Polici.

Fokusi i aktivitetit të zhvilluar, pranë ambjenteve të Policisë së Shtetit, ishte promovimi i Udhëzuesit "Roli i Psikologut në Polici".

Kjo punë e finalizuar me shumë sukses pati mbështetjen maksimale të Policisë së Shtetit dhe programit Pameca V. Ky është vetëm fillimi i një pune që do të vijojë të përmirësohet me trajnime, workshope, takime e udhëzues të tjerë.

Blv. Gjergj Fishta, Ndërtesa nr. 26, Kati II, Ap.9,Tiranë,
e-mail: sekretaria@urdhriipsikologut.al, Tel.: 0035542209927

Nëntor

Vijoi kalendari i takimeve dhe leksioneve të hapura, këtë herë me zhvillimin e leksionit me temë: "Standartizimi i proçedurave të komunikimit me prindërit dhe stafin pedagogjik tek psikologët shkollorë." Një leksion që përmbylli me sukses orientimin e psikologëve shkollorë mbi procedurat

dhe rrugën që duhet të ndjekin për ushtrimin korrekt të profesionit.

Urdhri i Psikologut ju bashkua nismës 16 ditore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për t'i thënë: "STOP DHUNËS ME BAZË GJINORE".

Ishte kënaqësi e mbi të gjitha detyrim që si institucion të ishim pjesë e një rrugëtimi sensibilizues e informues që zgjati 16 ditë, por që të gjithë kemi angazhimin maksimal që ky sensibilizim të vijojë të gjitha ditët e vitit.

Në datë 19 Nëntor, u mbajt online nga EFPA mbledhja e Presidentëve të Psikologëve Europianë.

Një mbledhje e përvitshme e të gjithë presidentëve të vendeve anëtarë, e cila këtë vit, në respektim të protokolleve të masave anti-Covid u zhvillua online.

Gjithashtu në këtë muaj, Presidentja e Urdhrit të Psikologut Dr.Valbona Treska ishte e ftuar në krah të Guvernatorit Z.Gent Sejko dhe Prof.Adrian Civici në hapjen e fushatës ndërgjegjësuese "As i vjetër e as i ri, jam thjesht LEK", të ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë.



Blv. Gjergj Fishta, Ndërtesa nr. 26, Kati II, Ap.9,Tiranë,
e-mail: sekretaria@urdhriipsikologut.al, Tel.: 0035542209927



Këtë muaj patëm kënaqësinë të zyrtarizonim edhe grupin e Koordinatorëve më të rinj Lokalë të Urdhrit të Psikologut, të cilët janë:

1. Znj.Alma Shyti - Koordinatore e Urdhrit të Psikologut, Qarku Lezhë.
2. Znj.Migena Haxhi - Koordinatore e Urdhrit të Psikologut, Qarku Shkodër.

3. Znj.Elisaveta Dino - Koordinatore e Urdhrit të Psikologut, Qarku Korçë.
4. Znj.Fatmira Lala - Koordinatore e Urdhrit të Psikologut, Lushnje.
5. Znj.Arta Beqiri - Koordinatore e Urdhrit të Psikologut, Qarku Dibër.
6. Znj.Veliona Hoxhaj - Koordinatore e Urdhrit të Psikologut, Qarku Vlorë.
7. Znj.Jonida Mustafaraj - Koordinatore e Urdhrit të Psikologut, Qarku Elbasan.
8. Znj.Loreta Mamani - Koordinatore e Urdhrit të Psikologut, Qarku Gjirokastër.

Prezantimi zyrtar i tyre u bë në ditët në vijim në çdo qark, nga ana e Zyrës Qendrore të Urdhrit të Psikologut.

Kishim kënaqësinë të nisnim turin e prezantimit të Koordinatorëve Lokalë me Vlorën. Një qytet që për herë të parë do të ketë një koordinator lokal, i cili do të lehtësojë dhe afrojë më tepër anëtarët e Urdhrit me zyrat qëndrore në Tiranë.

Në vijim të realizimit të leksioneve të hapura, këtë muaj u realizua me sukses leksioni i hapur me temë: "Ushtrimi i profesionit brenda kompetencave" me lektorë Dr. Valbona Treska dhe Av. Bledar Fejzo.

Dhjetor

U zhvillua Asambleja e Përgjithshme e Federatës Europiane të Psikologëve e cila edhe këtë vit u realizua online. Shqipëria u përfaqësua nga Presidentja Dr. Valbona Treska dhe Znj. Elona Mustafaraj anëtare e Këshillit Kombëtar.

Gjatë këtij muaji patëm kënaqësinë të prezantonim zyrtarisht përpara anëtarësisë, disa nga Koordinatorët



e rinj, të përzgjedhur, të cilët do të jenë bashkëpunëtorët e ardhshëm të institucionit tonë, e që me kontributin e tyre do të lehtësojnë ofrimin e shërbimeve ndërmjet zyrës qëndrore të Urdhrit të Psikologut në Tiranë dhe anëtarëve të Urdhrit të Psikologut në këto qarqe. Kështu gjatë këtij muaji prezantuam koordinatorët:

- Koordinatoren e Qarkut Lezhë kolegen Znj.Alma Shyti.
- Për herë të parë në Qarkun Elbasan prezantuam si Koordinatore të këtij qarku Znj.Jonida Mustafaraj.
- Koordinatoren e Qarkut Korçë kolegen Znj. Elisaveta Dino.
- Në qytetin e Lushnjës prezantuam si Koordinatore për anëtarët e Urdhrit të Psikologut në këtë qytet, kolegen Znj.Fatmira Lala.
- Prezantuam në Shkodër Koordinatoren Znj. Migena Haxhi.

Në këtë muaj patëm kënaqësinë të prezantonim edhe koordinatoren e Qarkut Shkodër Znj.Migena Haxhi.

Në këtë takim u diskutua mes kolegëve problematika që shqetësojnë komunitetin e këtij qarku e që do të adresohen e ndiqen për zgjidhje.

Blv. Gjergj Fishta, Ndërtesa nr. 26, Kati II, Ap.9,Tiranë,
e-mail: sekretaria@urdhriipsikologut.al, Tel.: 0035542209927

E mbyllëm vitin me një event të bukur e të rëndësishëm për psikologët që tashmë është kthyer në traditë çdo fundvit për shpalljen e "Psikologut të Vitit".

Të nominuarit nga vetë anëtarët për këtë vit ishin tre psikologë:

1. Z.Elidon Shehu
2. Znj.Irma Gjozi
3. Znj.Olta Jaçellari

Pas procesit të votimit u zgjodh fituese e çmimit simbolik "Psikologe e Vitit 2021" Znj.Olta Jaçellari puna e të cilës prej vitesh është e fokusuar si psikologe shkollore pranë Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë. Znj.Jaçellari është një profesioniste e nderuar, një psikologe model e mbi të gjitha një pikë referimi për psikologët e rinj pjesë e shërbimit psiko-social në institucionet arsimore.

2. ORGANET E URDHRIT TË PSIKOLOGUT DHE AKTIVITETI I TYRE FUNKSIONAL



Organet kryesore të Urdhrit të Psikologut janë:

a) Asambleja Kombëtare
b) Këshilli Kombëtar
c) Presidenti i Urdhrit
ç) Komisioni Etik i Gjykimit Disiplinor Profesional
d) Komisioni i Edukimit në Vazhdim
e) Komisione të tjera, ku përfshihen aktualisht Komisioni i Licencimit dhe Komisioni i Praktikave Profesionale.

Blv. Gjergj Fishta, Ndërtesa nr. 26, Kati II, Ap.9,Tiranë,
e-mail: sekretaria@urdhriipsikologut.al, Tel.: 0035542209927

2.1 ASAMBLEJA KOMBËTARE

- Organi më i lartë drejtues i Urdhrit të Psikologut, bazuar në ligjin nr. 40/2016, është Asambleja Kombëtare.
- Asambleja Kombëtare përbëhet nga të gjithë anëtarët e Urdhrit të Psikologut.
- Asambleja Kombëtare ka këto funksione:
- Zgjedh Këshillin Kombëtar dhe Presidentin e Urdhrit, me votim të fshehtë dhe me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve të saj;
- Miraton statutin e Urdhrit;
- Miraton Kodin e Etikës dhe Deontologjisë;
- Miraton rregulloren për gjykimin disiplinor profesional;
- Miraton rregulloren për regjistrimin, anëtarësimin dhe licencimin;
- Miraton rregulloren për organizimin e praktikës profesionale;
- Shqyrton dhe miraton projekt-buxhetin e Urdhrit, si dhe shqyrton buxhetin faktik të tij;
- Analizon veprimtarinë vjetore të organeve të Urdhrit;
- Shqyrton raportin e auditit të jashtëm, në intervale tre vjeçare.

Asambleja e V-të Kombëtare, i zhvilloi punimet në datë 18.06.2021 ora 10:00 pranë ambienteve të jashtme të Pallatit të Brigadave me këtë rend dite:

- Hapja e punimeve të Asamblesë së V-të Kombëtare.
- Përshëndetje e Z.Elton Kuqja në cilësinë e ish-Koordinatorit të Qarkut Durrës.
- Përshëndetje e anëtarit të ri të Këshillit Kombëtar Z.Besmir Frroku.
- Përshëndetje e Presidentes së Urdhrit të Psikologut.
- Analizë e veprimtarisë vjetore të organeve të Urdhrit të Psikologut.
- Miratimi i buxhetit faktik të vitit 2020, miratuar nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut me vendim nr. 5, datë 28.05.2021.
- Miratimi i projekt-buxhetit të vitit 2021, miratuar nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut me vendim nr. 23, datë 17.12.2020.
- Miratimi i ndryshimeve të Rregullores së Rregjistrim Anëtarësim Licencimit, miratuar nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut me vendim nr. 12, datë 28.05.2021.
- Miratimi i ndryshimeve të Rregullores së Gjykimit Etik e Profesional, miratuar nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut me vendim nr. 8, datë 28.05.2021.
- Hapësirë e lirë për diskutime.

Asambleja u zhvillua me sukses dhe me diskutime konstruktive, duke miratuar të gjitha pikat e rendit të ditës.

- Asambleja e V-të Kombëtare mori vendim:
- Të miratojë me unanimitet nga 84 anëtarët prezent në Asamble, Buxhetin Faktik të vitit 2020.
- Të miratojë me unanimitet nga 84 anëtarët prezent në Asamble, Projekt-Buxhetin e vitit 2021.
- Të miratojë me unanimitet nga 84 anëtarët prezent në Asamble, ndryshimet në Rregulloren e Rregjistrim Anëtarësim Licencimit.
- Të miratojë me unanimitet nga 84 anëtarët prezent në Asamble, ndryshimet në Rregulloren e Gjykimit Disiplinor Profesional.

Pas punimeve të Asamblesë anëtarët patën mundësinë të shpenzonin kohë së bashku duke diskutuar dhe ndarë eksperiencat e tyre. Zhvillimi i Asambleve Kombëtare është jo vetëm një detyrim që rrjedh nga ligji, por edhe një formë për të bashkëuar më shumë profesionistët e të gjithë Shqipërisë mes tyre.

2.2 KËSHILLI KOMBËTAR

Këshilli Kombëtar është organi ekzekutiv i Urdhrit, i cili përbëhet nga 16 anëtarë.
Anëtarë të zgjedhur të Këshillit Kombëtar janë:
Dr.Fleura Shkëmbi, Dr.Valbona Habili, Dr.Edvin Lame, Dr.Artemisi Dono, Znj.Elona Mustafaraj, Znj. Rezarta Basha, Dr.Manolita Hida, Znj.Orjola Plaku, Z.Besmir Frroku, Z.Altin Nika, Z.Bledar Zeneli.
Në përbërje të Këshillit Kombëtar janë edhe 4 anëtarë të caktuar nga Ministritë, përkatësisht nga:

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (njëkohësisht edhe Autoriteti Kompetent i Urdhrit të Psikologut sipas ligjit)

- Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë
- Ministria e Drejtësisë
- Ministria e Mbrojtjes

Këshilli Kombëtar ka këto përgjegjësi:

a) miraton strukturën e vet organizative;
b) cakton kuotizacionin dhe tarifat;
c) administron pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të Urdhrit në nivel kombëtar;
ç) mbikëqyr të gjithë veprimtarinë e organeve që varen prej tij;
d) harton statutin, rregulloret e Urdhrit, si dhe Kodin e Etikës dhe Deontologjisë dhe ia propozon ato për miratim Asamblesë Kombëtare;
dh) mban dhe përditëson Regjistrin e Urdhrit të Psikologut;
e) ngre grupe pune ad-hoc për kryerjen e kontrolleve në ushtrimin e profesionit të psikologut;
ë) përgatit publikon raportin vjetor dhe financiar.

Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut të Republikës së Shqipërisë, përgjatë këtij viti ka patur një aktivitet shumë të ngjeshur.

Janë marrë një sërë vendimesh të rëndësishme gjatë vitit 2021.

Këshilli Kombëtar ka marrë vendimet e mëposhtme:

1. Vendim Nr.1, dt.03.02.2021, "Për ndryshimin e Vendimit Nr.9 të Komisionit të Etikës. Dhënien e masës: Vërejtje me paralajmërim për heqjen e të drejtës së ushtrimit të profesionit".
2. Vendim Nr.2, dt.03.02.2021, "Për miratimin e Rregullores së Zgjedhjeve të Urdhrit të Psikologut".
3. Vendim Nr.3, dt.03.02.2021 "Për fillimin e efekteve të masës disiplinore të dhënë prej Komisionit të Etikës për psikologen E.M prej datës së dhënies së Vendimit".
4. Vendim Nr.4, dt.03.02.2021 "Për miratimin e honorareve shpërblyese për punën vullnetare të individëve të caktuar pranë zyrës së Urdhrit të Psikologut".
5. Vendim Nr.5, dt.28.05.2021, "Për miratimin e Buxhetit Faktik 2020".
6. Vendim Nr.6, dt.28.05.2021, "Për miratimin e Raportit Vjetor 2020".
7. Vendim Nr.7, dt.28.05.2021, "Për refuzimin e shqyrtimit të ankesës së Znj.A.B. drejtuar Këshillit Kombëtar".
8. Vendim Nr.8, dt.28.05.2021, "Për miratimin e ndryshimeve në Rregulloren e Gjykimit Disiplinor e Profesional sa i takon ankesave të cilat mund t'i drejtohen Këshillit Kombëtar".
9. Vendim Nr.9, dt.28.05.2021, "Për refuzimin e ankesës së Znj.M.B. drejtuar Këshillit Kombëtar".
10. Vendim Nr.10, dt.28.05.2021, "Për ndryshimin e pagave të administratës që punojnë me kohë të plotë".
11. Vendim Nr.11, dt.28.05.2021 "Për miratimin e ndryshimit të vlerave të honorareve për ekspertët e Edukimit në Vazhdim për aktivitete që zgjasin mbi tre ditë dhe aktivitete që përsëriten".
12. Vendim Nr.12, dt.28.05.2021, "Për zgjedhjen e anëtarëve të rinj të Komisionit të Licencimit".
13. Vendim Nr.13, dt.28.05.2021, "Për zgjedhjen e anëtarëve të rinj të Komisionit të Praktikës".
14. Vendim Nr.14, dt.21.12.2021, "Për miratimin e honorareve për Ekspertët e Jashtëm të KEVP-së që kryejnë vetëm vlerësimin e jashtëm të aktivitetit".
15. Vendim Nr.15, dt.21.12.2021, "Për miratimin e ndryshimit të honorareve për mbledhjet e Këshillit Kombëtar".
16. Vendim Nr.16, dt.21.09.2020, "Për ndryshimin e Vendimit Nr.9 të Komisionit të Edukimit në Vazhdim".
17. Vendim Nr.17, dt.21.09.2020, Për miratimin e projekt-buxhetit për vitin financiar 2022" ku përfshihet edhe ndryshimi i kuotizacioneve.

2.3 ORGANIZIMI I ZGJEDHJEVE PËR ORGANET DREJTUESE TË URDHRIT TË PSIKOLOGUT 27.03.2021

Në datë 27.03.2021, u mbajtën zgjedhjet për organet drejtuese të Urdhrit të Psikologut. Me miratimin e Rregullores së Zgjedhjeve të Urdhrit nga ana e Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut, me vendimin nr.2, datë 03.02.2021, administrata e Urdhrit të Psikologut është organi përgjegjës për organizimin dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve për organet drejtuese të Urdhrit të Psikologut. Këto zgjedhje u zhvilluan

Blv. Gjergj Fishta, Ndërtesa nr. 26, Kati II, Ap.9,Tiranë,
e-mail: sekretaria@urdhriipsikologut.al, Tel.: 0035542209927

në ambientet e Faklultetit të Gjuhëve të Huaja, në një ambient që garantoi zbatimin me korrektësi të masave e protokolleve anti COVID-19. Në këto zgjedhje morën pjesë 420 psikologë, anëtarë të Urdhrit të Psikologut.

Bazuar në Rregulloren e Zgjedhjeve, të gjithë psikologët e interesuar për të kandiduar në këto zgjedhje, patën kohën e nevojshme për të depozituar kërkesën e tyre për aplikim shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm, në përmbushje të kritereve të Ligjit Nr.40/2016 "Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë" dhe të Rregullores së Zgjedhjeve të Urdhrit të Psikologut.

Kandidaturat për t'u zgjedhur në organet drejtuese të Urdhrit të Psikologut ishin:

Për President të Urdhrit të Psikologut, kandidaturë e vetme:
- Dr. Valbona Treska

Për anëtar të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut (kategoria pedagogë), kandiduan 4 anëtarë:
- Dr. Edvin Lame
- Prof. Dr. Artemisi Shehu
- Dr. Valbona Habili
- Dr. Migena Buka

Për anëtar të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut (kategoria shërbime), kandiduan 13 anëtarë:
- Dr. Fleura Shkëmbi
- Dr. Arben Hoti
- Z. Bledar Zeneli
- Z. Altin Nika
- Z. Orjola Plaku
- Z. Besmir Frroku
- Z. Rezarta Basha
- Z. Aurora Memushaj
- Z. Elsa Kera
- Z. Elton Kuqja
- Z. Sonila Luzi
- Z. Fatjon Taipi
- Dr. Manolita Hida

Për anëtar të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut (kategoria shoqatat), kandidaturë e vetme:
- Znj. Elona Mustafaraj

Pas përfundimit të zgjedhjeve dhe numërit të votave, u shpallën këto kandidatura fituese:

Për zgjedhjen e Presidentit të Urdhrit të Psikologut:
1. Dr. Valbona Treska

Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut (kategoria Pedagogë)
1. Prof. Dr. Artemisi Shehu
2. Dr. Edvin Lame
3. Dr. Valbona Habili

Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut (kategoria Shërbime)
1. Dr. Fleura Shkëmbi
2. Znj. Rezarta Basha
3. Znj. Orjola Plaku
4. Z. Altin Nika
5. Z. Besmir Frroku
6. Dr. Manolita Hida
7. Z. Bledar Zeneli

Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar (kategoria Shoqatat)
1. Znj. Elona Mustafaraj

Këto zgjedhje dëshmuan përgjegjësi të lartë profesionale etike dhe mbi të gjitha pjesëmarrje të lartë të psikologëve nga çdo vend i Shqipërisë të cilët vlerësuan dhe mbështetën punën e deritanishme të institucionit dhe shprehen vullnetin e tyre për t'u përfaqësuar në organet drejtuese.

2.4 KOMISIONI I GJYKIMIT DISIPLINOR PROFESIONAL

Ky komision është ngritur pranë Urdhrit të Psikologut në zbatim të nenit 19 të Ligjit nr. 40/2016 "Për Urdhrin e Psikologut".

Komisioni Etikës dhe Gjykimit Disiplinor Profesional ka në strukturën e tij 5 anëtarë prej të cilëve 4 psikologë me një eksperiencë pune mbi 10-vjecare në profesion dhe përfaqësuesin e Zyrës Juridike të Urdhrit:

Dr.Jonida Haxhiu, Dr.Enila Cenko, Dr.Brunilda Laboviti, Znj.Redina Balla, dhe juristi i Urdhrit Z.Igli Çutra.

Komisioni funksionon në bazë të ligjit për Urdhrin e Psikologut, Kodit të Etikës dhe Deontologjisë si dhe Rregullores së Gjykimit Disiplinor e Profesional. Gjatë vitit 2020 Komisioni Etik i Gjykimit Disiplinor Profesional ka shqyrtuar gjithsej 5 raste, të iniciuara nga individë të ndryshëm.

Komisioni i Etikës pas shqyrtimit të rasteve ka dhënë këto vendime:

Në 3 raste janë konstatuar shkelje të Kodit të Etikës dhe janë dhënë masa të ndryshme disiplinore kundrejt psikologëve të tilla si: vërejtje me paralajmërim si dhe përjashtim nga U.P. për një periudhë 3 mujore.

Në 2 raste, pas shqyrtimit të çështjes, Komisioni Etik nuk ka konstatuar raste të shkeljes së Kodit të Etikës, ndaj kërkesa e palëve ankuese është rrëzuar.

2.5 KOMISIONI I EDUKIMIT NË VAZHDIM NË PSIKOLOGJI

Në bazë të akteve ligjore në fuqi, ky Komision zgjidhet nga Këshilli Kombëtar dhe drejtohet nga Presidenti i Urdhrit.

Në përbërje të tij janë anëtarët e mëposhtëm: Prof.Dr.Theodhori Karaj, Prof.As.Dr.Zenel Orhani, Prof.As.Dr.Erika Melonashi, Dr.Marsela Shehu dhe Dr.Valbona Treska në cilësinë e Presidentes së U.P.

Pas krijimit të tij tre vite më parë dhe pas plotësimit të të gjitha akteve normative që e bën atë të jetë funksional, ky Komision vijoi punën normalisht edhe gjatë vitit 2021, duke shqyrtuar aplikimet për akreditim dhe kërkesat për ripërsëritje të aktiviteteve të subjekteve të cilat ishin të interesuara të kryenin aktivitete të akredituara të edukimit në vazhdim në psikologji. Gjatë vitit 2021 nga ky komision janë marrë vendimet e mëposhtme:

Vendimi Nr.1, datë 28.01.2021

- Të miratojë shpërndarjen e krediteve për aktivitetin e përsëritur të QKSHP me temë: "Ndërhyrjet psikologjike te fëmijët dhe adoleshentët".
- Të akreditojë aktivitetin e QKSHP me temë: "Vlerësimi i procesit të të mësuarit".
- Të akreditojë aktivitetin e QKSHP me temë: "Stresi në punë".

Blv. Gjergj Fishta, Ndërtesa nr. 26, Kati II, Ap.9,Tiranë,
e-mail: sekretaria@urdhriipsikologut.al, Tel.: 0035542209927

- Të miratojë shpërndarjen e krediteve për aktivitetin e ISHPK, me temë: "Njohja dhe trajtimi i çrregullimeve sjellore tek fëmijët dhe adoleshentët".
- Të lërë për plotësim të dokumentacionit aktivitetin me temë: "Vlerësimi psikodiagnostik i fëmijëve në moshën shkollore", nga EMDR.

Vendimi Nr.2, datë 05.03.2021

- Të miratojë shpërndarjen e krediteve për aktivitetin e qendrës "ISHPK", me temë: "Programi PBS për trajnimin dhe menaxhimin e sjelljeve".
- Të miratojë shpërndarjen e krediteve për aktivitetin e qendrës QKSHP, me temë: "Vlerësimi i procesit të të mësuarit".
- Të miratojë shpërndarjen e krediteve për aktivitetin e qendrës QKSHP, me temë: "Stresi në punë".
- Të miratojë shpërndarjen e krediteve për aktivitetin e qendrës "Të dëgjoj 366", me temë: "Raporti i vlerësimit psikologjik".
- Të miratojë shpërndarjen e krediteve për aktivitetin e qendrës "Të dëgjoj 366", me temë: "Autizmi si kompleks neurobiologjik".
- Të miratojë shpërndarjen e krediteve për aktivitetin e Qendrës së Trajnimit dhe Mbështetjes shkollore "Faik Konica" me temë: "Vlerësimi psikologjik te fëmijët në moshën shkollore".
- Të miratojë shpërndarjen e krediteve për aktivitetin e Qendrës së Trajnimit dhe Mbështetjes shkollore "Faik Konica" për aktivitetin e përsëritur me temë: "Terapia përmes artit dhe lojës".
- Të miratojë kreditet për aktivitetin e Qendrës së Trajnimit dhe Mbështetjes shkollore "Faik Konica" me temë: "Përdorimi i instrumentave psiko-metrikë profesional të kryer nga institucioni/ qendra".
- Të miratojë shpërndarjen e krediteve për aktivitetin e "QSUT", me temë: "Cikël seminaresh dhe leksionesh për psikologët dhe punonjësit social".
- Të miratojë kreditet për aktivitetin, me temë "Psikoterapia Biheiviorale përmes internetit për depresionin", të ofruar nga Klinika Psikologjike "Urtësia".

Vendimi Nr.3, datë 27.04.2021

- Të miratojë kreditet për aktivitetin e përsëritur të qendrës "Faik Konica" me temë: "Vlerësimi psikologjik tek fëmijët e moshës shkollore.
- Të kthehet Raporti Përfundimtar i ekspertit për aktivitetin e qendrës "Faik Konica", të përsëritur me temë: "Ç'rregullimi i varësisë dhe abuzimit me substancat", pasi duhet plotësuar me rekomandimet e shpjegimet përkatëse sipas kategorive.
- Të miratojë shpërndarjen e krediteve për aktivitetin e përsëritur të qendrës ISHPK me temë: "Njohja dhe trajtimi i ç'rregullimeve sjellore tek fëmijët dhe adoleshentët",
- Të përzgjidhen si Ekspertë të Jashtëm, për vlerësimin e monitorimin e aktiviteteve të Edukimit në Vazhdim për psikologët 4 kandidatura, sipas nevojave të plotësimit të listës ekzistuese të ekspertëve, përkatësisht Znj.Ardiola Bodinaku, Znj.Milita Tupi, Znj.Sonila Luzi dhe Z.Ronin Hoxha, me unanimitet të plotë nga të gjithë anëtarët e pranishëm të komisionit.

Vendimi Nr.4, datë 12.05.2021

- Të ndryshojë Vendimin Nr.1, datë 23.04.2020 dhe të rifillojnë aktivitetet e Edukimit në Vazhdim me pjesëmarrje të drejtëpërdrejtë (fizikisht).
- Të miratojë shpërndarjen e krediteve për aktivitetin e përsëritur me temë: "Ç'rregullimi i varësisë dhe abuzimit me substancat", të qendrës "Faik Konica".
- Të miratojë shpërndarjen e krediteve për aktivitetin e përsëritur me temë: Programi PBS për trajtimin dhe menaxhimin e sjelljeve në shkollë", të qendrës "ISHPK" me 8 kredite me eksperte Znj.Fleura Shkembi.
- Të lihet për plotësim dosja për akreditimin e aktivitetit të CBT, me temë: "Disforia Gjinore" me eksperte Znj.Eriona Kola.
- Të lihet për plotësim aplikimi për akreditimin e aktivitetit të CBT, me temë: "Varësitë dhe trajtimi i tyre. Varësia nga bixhozi" me ekspert Znj.Elona Hasmujaj.

Vendimi Nr.5, datë 11.06.2021

- Të lihet për plotësim aplikimi për akreditim të qendrës "Faik Konica", për aktivitetin me temë: "Terapia e artit në vlerësimin psikologjik të fëmijëve".
- Të akreditojë aktivitetin e me temë: "Perdorimi i instrumentave psikometrike profesionale", të qendrës "Faik Konica".
- Të lihet për plotësim aplikimi për akreditim i

aktivitetit me temë: "Autizmi dhe ndërhyrja fillestare me terapinë ABA dhe Bazat e Psikomotricitetit në trajtimin e problematikave të zhvillimit", ofruar nga qendra "EQUILIBRIUM".
- Të akreditojë aktivitetin e qendrës CBT, me temë: "Disforia Gjinore"
- Të akreditojë aktivitetin e qendrës CBT, me temë: "Varësitë dhe trajtimi i tyre. Varësia nga bixhozi"
- Të lihet për plotësim aplikimi për akreditim i Universitetit "Marin Barleti", për aktivitetin e me temë: "Metoda të përfshirjes efektivetë fëmijëvenë spektrin e çrregullimit autik në klasa gjithëperfshirëse".
- Të akreditojë aktivitetin e qendrës "Të degjoj 366", për aktivitetin me temë: "Emocionet, një udhëtim në zbulim të vetes dhe të tjetrit".

Vendimi Nr.6, datë 09.07.2021
- Të akreditojë aktivitetin e me temë: "Terapia e artit në vlerësimin psikologjik të fëmijëve", të qendrës "Faik Konica".
- Të akreditojë aktivitetit e qendrës EQUILIBRIUM, me temë: "Autizmi dhe ndërhyrja me terapinë ABA dhe bazat e psikomotricitetit në trajtimin e problematikave të zhvillimit".
- Të akreditojë aktivitetin e Universitetit "Marin Barleti", me temë: "Metoda të përfshirjes efektive të fëmijëve në spektrin e çrregullimit autik në klasa gjithëperfshirëse".
- Të lihet për plotësim aplikimi për akreditim i Qendrës "Inner Life" për aktivitetin me temë: "Komunikimi Pohues Ndërpersonal".
- Të akreditojë aktivitetin e Qendrës "Inner Life" me temë: "Inteligjencat e shumëfishta dhe stilet e të nxënit".
- Të miratojë shpërndarjen e krediteve për aktivitetin e akredituar me temë: "Përdorimi i instrumentave psikometrike profesionale", nga qendra "Faik Konica".

Vendimi Nr.7, datë 23.09.2021
- Të lërë për plotësim aplikimin për miratimin e krediteve për aktivitetin me temë: "Terapia e artit në vlerësimin psikologjik të fëmijëve", të qendrës "Faik Konica".
- Të miratojë shpërndarjen e krediteve për aktivitetin e qendrës EQUILIBRIUM, me temë: "Autizmi dhe ndërhyrja me terapinë ABA dhe bazat e psikomotricitetit në trajtimin e problematikave të zhvillimit".
- Të miratojë shpërndarjen e krediteve për aktivitetin e CBT, me temë: "Disforia Gjinore".
- Të lërë për plotësim aplikimin për miratimin e krediteve për aktivitetin e CBT, me temë: "Varësitë dhe trajtimi i tyre. Varësia nga bixhozi".
- Të miratojë akreditimin e aktivitetit të Qendrës "Inner Life" me temë: "Inteligjencat e shumëfishta dhe stilet e të nxënit".
- Të miratojë shpërndarjen e krediteve për aktivitetin e ZVA Durrës me temë: "Aftësia e kufizuar në institucionet arsimore".

Vendimi Nr.8, datë 25.10.2021
- Të miratojë me 5 kredite aktivitetin me temë: "Terapia e artit në vlerësimin psikologjik të fëmijëve", të qendrës "Faik Konica".
- Të miratojë me 10 kredite aktivitetin e CBT, me temë: "Varësitë dhe trajtimi i tyre. Varësia nga bixhozi".
- Të miratojë me 10 kredite aktivitetin e Universitetit "Barleti", me temë: "Metoda të përfshirjes efektive të fëmijëve në spektrin e çrregullimit autik në klasa gjithëperfshirëse".

Vendimi Nr.9, datë 22.11.2021
- Të lërë për plotësim aplikimin për akreditim për aktivitetin me temë me temë: "CBT për PTSD; Trajtimi i stresit post traumatik dhe PE, Prolonged exposure".
- Refuzimin e kërkesës për akreditim qendrës "Faik Konica", me temë: "ACT në praktikën klinike, integrimi i metodave në këshillim dhe psikoterapi", me arsyetimin se:
- Në kundërshtim me Rregulloren e Edukimit në Vazhdim dhe Përmbledhjen e rregullave të Edukimit në Vazhdim, të miratuara nga KEVP, Qendra "Faik Konica" ka publikuar datën dhe orën e aktivitetit.
- Të lërë për plotësim aplikimin për akreditim për aktivitetin e Qendrës "Faik Konica" me temë: "Trajtimi i problemeve psikologjike të shkaktuara nga emergjencat".
- Të miratojë në masën e 10 krediteve për 2 ditët e trajnimit me temë: "Emocionet, një udhëtim në zbulim të vetes dhe të tjetrit" realizuar nga Qendra "Të dëgjoj 366".

Blv. Gjergj Fishta, Ndërtesa nr. 26, Kati II, Ap.9,Tiranë,
e-mail: sekretaria@urdhriipsikologut.al, Tel.: 0035542209927

- Të miratojë akreditimin e aktivitetit të Marin Barleti, me temë: "Ndërhyrja e parë psikologjike në shkolla" me 15 kredite.
- Të miratojë akreditimin e aktivitetit të Marin Barleti, me temë: "Teknikat efikase dhe praktike të menaxhimit të ankthit" me 5 kredite.

2.6 ADMINISTRATA E URDHRIT TË PSIKOLOGUT

Administrata e Urdhrit të Psikologut përbëhet nga:
Zyra Juridike – një punonjës, Z.Igli Çutra
Zyra e Financës – një punonjës, Z.Lejdi Goga
Sekretariati, Protokolli, Arshiva – një punonjëse, Znj. Armira Baboçi
Zyra e IT-së – një punonjës part-time, Z.Enn Tusha



2.7 KOMISIONE TË TJERA

Pranë Urdhrit të Psikologut funksionojnë disa komisione të tjera, të cilat janë të domosdoshme për realizimin e misionit të tij.

2.7.1 Komisioni i Licencimit

Ky Komision është ngritur nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut dhe shqyrton kërkesat për licencim të të gjithë atyre psikologëve, që në bazë të ligjit dhe akteve normative në fuqi, përjashtohen nga detyrimi për kryerjen e praktikës profesionale dhe provimit të shtetit.

Ai përbëhet nga Presidentja Znj.Valbona Treska, juristi Z.Igli Çutra, sekretaria Znj.Armira Baboçi si dhe nga anëtarët e Këshillit Kombëtar: Dr.Edvin Lame dhe Dr.Fleura Shkembi.

Gjatë vitit 2021 ky komision ka licencuar 74 psikologë të rinj, të ndarë sipas fushave të mëposhtme:

- Psikologë klinikë - 35 anëtarë
- Psikologë shkollorë dhe organizacionalë - 4 anëtarë
- Psikologë këshillimi - 10 anëtarë
- Psikologë të përgjithshëm - anëtar
- Psikologë shkollorë - 11 anëtarë
- Psikologë në institucione - 3 anëtarë
- Psikologë ligjorë - 2 anëtarë
- Psikologë në orientim profesional - 2 anëtarë
- Psikologë organizacionalë - 5 anëtarë
- Psikologë edukimi - 1 anëtar
- Psikologë zhvillimi - 1 anëtar

2.7.2 Komisioni i Praktikës Profesionale

Ky komision është ngritur nga Këshilli Kombëtar për efekt të zbatimit të "Rregullores së Praktikës Profesionale", e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në cilësinë e autoritetit kompetent, e cila mundëson rregullimin ligjor të vijimit të procedurave për një numër të konsiderueshëm psikologësh të sapodiplomuar dhe përjashtimin nga kjo praktikë për një kategori tjetër.

Komisioni i Praktikës Profesionale drejtohet nga Presidenti i Urdhrit dhe përbëhet nga anëtarët e zgjedhur nga Këshilli Kombëtar, konkretisht: Dr.Valbona Habili, Znj. Plaku si dhe nga juristi i

Urdhrit të Psikologut, Z.Igli Çutra dhe sekretarja Znj. Armira Baboçi.

Këtë vit janë regjistruar pranë Urdhrit të Psikologut 168 praktikantë me kontrata të rregullta punësimi në institucione të ndryshme shtetërore dhe private. Komisioni i Praktikës ka shqyrtuar gjatë vitit 2021 dosjet e 20 psikologëve dhe, pas shqyrtimit të tyre ka vendosur:

- 9 psikologë të përjashtohen nga detyrimi i kryerjes së praktikës profesionale, bazuar në Memorandumin e Bashkëpunimit mes U.P. dhe MSHMS.
- 6 psikologë janë vlerësuar se duhet të kryejnë praktikë të pjesshme profesionale.
- 5 psikologë janë vlerësuar se duhet të kryejnë praktikën e plotë profesionale.

2.7.3 Komisioni i Vlerësimit të Aftësimit Praktik

Ky komision është ngritur bazuar në Urdhrin Nr.580, datë 31.07.2019 "Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit e Aftësimin Praktik për Profesionin e Psikologut" të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ka si qëllim të vlerësojë praktikën profesionale të supervizuar të çdo psikologu që i nënshtrohet kësaj procedure.

Me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bazuar në nenin 17 të Urdhrit të përbashkët të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë, "Për miratimin e Rregullores së Praktikës Profesionale" anëtarët e këtij komisioni janë si më poshtë: Znj.Aleksandra Puci, kryetare e komisionit dhe përfaqësuese e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Z.Besmir Frroku dhe Z.Edvin Lame, përfaqësues të Urdhrit të Psikologut. Komisioni ka hartuar fillimisht pyetjet



orientuese për provimin e praktikës profesionale, pyetje të cilat janë publikuar paraprakisht në website-n e Urdhrit të Psikologut https://www.urdhriipsikologut.al/fondi-i-pyetjeve/, sipas afateve të parashikuara në rregullore. Këtë vit provimi u zhvillua në datat 17-18-19-20-21 maj 2021 pranë ambienteve të Urdhrit të Psikologut dhe në listën e provimit ishin 103 praktikantë të cilët ju nënshtruan VAP-it, prej të cilëve 3 praktikantë nuk u paraqitën ditën e provimit, 1 praktikant nuk e kaloi provimin dhe 99 praktikantë rezultuan kalueshëm në provimin e VAP.

2.8 KOORDINATORËT LOKAL

Ky rrjet ka si qëllim ofrimin e mbështetjes, ndihmës dhe mbrojtjes së interesave për të gjithë anëtarët e Urdhrit të Psikologut të qarkut përkatës, duke patur në fokus nevojat dhe problematikat që ata ndeshin gjatë ushtrimit të profesionit të psikologut. Pas zhvillimit të zgjedhjeve në muajin mars për organet drejtuese të Urdhrit të Psikologut, Presidentja e Urdhrit Znj. Valbona Treska, mendoi të rifreskojë edhe grupin e koordinatorëve të cilët bashkëpunuan ngushtësisht me Urdhrin e Psikologut, përgjatë kësaj periudhe kohe.

Ky rifresikim u bë për t'i dhënë mundësinë çdo anëtari, i cili mendon se mund të ofrojë shërbimin e tij në drejtim të komunitetit të kolegëve psikologë të vendit ku ushtron profesionin, duke kryer punën koordinuese me zyrën tonë qendrore të Urdhrit të Psikologut.

Rrjeti i Koordinatorëve Lokalë funksionin në mënyrë vullnetare.

Koordinatori lokal ka si mision:

- Kryerjen e shërbimeve për anëtarët e Urdhrit, në kuadër të shpërndarjes efektive të informacioneve që lidhen me ushtrimin e profesionit, mbledhjes dhe shpërndarjes së dokumentacionit specific, me qëllim përmirësimin e cilësisë së ushtrimit të profesionit të psikologut në institucionet përkatëse rajonale dhe uljen e kostove për përfitimin e këtyrë shërbimeve për anëtarët e Urdhrit në rajon.
- Vendosjen dhe ruajtjen e marrëdhënieve të Urdhrit me organet vendore dhe subjektet e tjera publike dhe private në rajon, me qëllim rritjen e ndikimit dhe faktorizimin e Urdhrit të Psikologut.

Disa nga funksionet që kryejnë Koordinatorët Lokalë janë:

Blv. Gjergj Fishta, Ndërtesa nr. 26, Kati II, Ap.9,Tiranë,
e-mail: sekretaria@urdhriipsikologut.al, Tel.: 0035542209927

- Dhënia e informacionit të detajuar për çdo psikolog, i cili do të kryejë procedurat e anëtarësimit, licencimit, zhvillimit të praktikës profesionale, provimit të shtetit, kryerjen e trajnimeve të ndryshme, etj.
- Mbledhja e të gjitha dokumentave të nevojshme të psikologëve të rajonit përkatës, përsa i përket procedurës së anëtarësim-liçensimit, si dhe të çdo dokumenti tjetër që lidhet me Urdhrin, dhe përcjellja e tyre pranë Urdhrit të Psikologut.
- Shpërndarja për psikologët e rajonit përkatës të lejes së ushtrimit individual të profesionit (Licencave Profesionale) apo e çdo dokumentacioni tjetër të lëshuar nga Urdhri për anëtarët e këtij rajoni.
- Krijimi dhe ruajtja e marrëdhënieve të bashkëpunimit, brenda rajonit, me institucionet publike, si dhe me çdo subjekt tjetër publik apo privat, që ka qëllime të përbashkëta me Urdhrin e Psikologut.
- Informimi i psikologëve të rajonit lidhur me vendimet dhe udhëzimet e Urdhrit të Psikologut.
- Mbështetja për organizimin dhe zhvillimin e veprimtarive studimore e shkencore në fushën e psikologjisë në rajon.
- Gjithashtu, Koordinatorët Lokalë pranojnë çdo ankesë të ardhur në drejtim të psikologëve, së bashku me të gjithë dokumentacionin shoqërues, dhe e dërgojnë atë pranë Zyrës Qendrore të Urdhrit të Psikologut, me qëllim inicimin e procedurave të shqyrtimit nga Komisioni Etik i Gjykimit Disiplinor Profesional.

Gjatë vitit 2021, rrjetit të koordinatorëve lokalë të Urdhrit të psikologut ju shtuan koordinatorët për Qarqet: Gjirokastër, Dibër, Elbasan, Vlorë dhe Lushnje, përpos koordinatorëve lokalë në Lezhë, Shkodër dhe Korcë.

Aktualisht, shpërndarja e rrjetit të koordinatorëve është si më poshtë:

Koordinatori Lokal për Qarkun e Shkodrës
Znj. Migena Burrja/Haxhi
Adresa: Rr ”At Gjergj Fishta” Nd.37 Kati I-rë
Tel: 0693129434
e-mail: Qarkushkoder@urdhriipsikologut.al

Koordinatori Lokal për Qarkun e Vlorës
Znj. Veliona Hoxhaj
Adresa: Rr ”Sulejman Delvina” Lgj Hajro Cakerri, Pall Lor, Kati II-të
Tel: 0674060444
e-mail: Qarkuvlore@urdhriipsikologut.al

Koordinatori Lokal për Qarkun e Lezhës:
Znj. Alma Shyti
Adresa: Shkolla “Kolin Gjoka”
Tel: 0683296435
e-mail: Qarkulezhe@urdhriipsikologut.al

Koordinatori Lokal për Qarkun e Korçës:
Znj. Elizaveta Dino
Adresa: Qendra e Shëndetit Mendor, Korçë
Tel.: 0696171870
e-mail:Qarkukorce@urdhriipsikologut.al

Koordinatori Lokal për Qarkun e Elbasanit
Znj. Jonida Mustafaraj
Adresa: Qendra Shqiptare për Integrimin e Njerëzve me Nevoja të Vecanta
Tel: 0693847103
e-mail: Qarkuelbasan@urdhriipsikologut.al

Koordinatori Lokal për Qytetin e Lushnjës
Znj.Fatmira Lala
Adresa: Shkolla “Kongresi i Lushnjes”
Tel: 0692626443
e-mail:koordinatorlokallushnje@urdhriipsikologut.al

Koordinatori Lokal për Qarkun e Gjirokastrës
Znj.Loreta Mamani
Adresa: Gjirokastër
Tel: 0694640798
e-mail: Qarkugjirokaster@urdhriipsikologut.al

Koordinatori Lokal për Qarkun e Dibrës
Znj.Arta Beqiri
Adresa: Bulqizë
Tel: 0698220502
e-mail: Qarkudiber@urdhriipsikologut.al

3. ANËTARËSIA E URDHRIT TË PSIKOLOGUT

Për të qenë anëtar i Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë, psikologët duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

1. Të kenë diplomën e studimeve të larta "Bachelor" dhe "Master shkencor" ose "Master profesional" në psikologji ose ekuivalent me të, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë, brenda apo jashtë vendit, të njohura nga ministria përgjegjëse për arsimin;
2. Të mos jenë të dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që lidhet me ushtrimin e profesionit, në momentin e kërkesës për anëtarësim.

Anëtarësia ka patur një rritje gjatë vitit 2021. Administrata e Urdhrit në vazhdimësi ka bërë një punë të madhe sensibilizuese kundrejt psikologëve, por edhe kundrejt institucioneve publike e private, të cilat janë ndërgjegjësuar për nevojën e zbatimit të ligjit.

Në total Urdhri i Psikologut për vitin 2021 ka arritur në 1619 anëtarë të regjistruar aktivë dhe joaktivë në profesion.

3.1 PSIKOLOGË TË LICENCUAR

Licencimi i psikologëve rregullohet në bazë të Ligjit "Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë". Sipas këtij ligji, pas përmbylljes së studimeve Bachelor dhe Master në psikologji, duhet të kryhet praktika një vjeçare profesionale dhe më pas të jepet provimi i shtetit, si parakusht për licencimin.

Përjashtimisht, në këtë ligj parashikohet se psikologët të cilët e kanë ushtruar profesionin përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përjashtohen nga detyrimi për të dhënë provimin e shtetit.

Komisioni i Licencimit, duke marrë për bazë vendimin e ardhur nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me Nr.493 (80-2020-528), datë 17.02.2020, në lidhje me psikologen Znj.E.N., vendosi të shqyrtojë dhe të aprovojë Lejen Individuale për Ushtrimin e Profesionit të Psikologut (Licencën Profesionale) edhe për kategorinë e psikologëve të cilët kanë përfunduar një cikël studimi në psikologji dhe kanë ushtruar profesionin para hyrjes në fuqi të ligjit 40/2016 "Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë" .

Në këto kushte, në përmbushje të detyrimeve ligjore, Urdhri ka vijuar procesin e licencimit për këtë kategori të psikologëve, bazuar në Ligjin Nr.10171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në R.Sh" dhe Memorandumin e Bashkëpunimit mes ish-Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe Urdhrit të Psikologut.

[1] Neni 9 i Ligjit Nr.10 171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), pika 4.:Përjashtohet nga detyrimi për të dhënë provimin e shtetit: a) profesionisti që, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ushtron ose ka ushtruar një profesion të rregulluar;

Blv. Gjergj Fishta, Ndërtesa nr. 26, Kati II, Ap.9,Tiranë,
e-mail: sekretaria@urdhriipsikologut.al, Tel.: 0035542209927

Aktualisht, licencimi i psikologëve sipas fushës së kompetencës paraqitet si më poshtë:

Psikologë të licencuar sipas viteve	2017	2018	2019	2020	2021	Total
Total të Licencuar	**307**	**175**	**71**	**101**	**74**	**728**
Psikologë Klinikë	147	97	32	32	35	343
Psikologë Shkollorë Organizacionalë	48	19	14	7	4	92
Psikologë Shkollorë	28	14	3	27	11	83
Psikologë Organizacionalë	8	13	2	7	5	35
Psikologë në Institucione	17	6	3	5	3	34
Psikologë në Orientim Profesional	9	3	2	1	2	17
Psikologë në Këshillim Psikologjik	41	25	9	18	10	103
Psikologë në Kërkim Psikologjik	5	2	2	1	-	10
Psikologë Ligjorë	5	2	2	3	2	14
Psikologë të Përgjithshëm	8	2	6	2	1	19
Psikologë Komuniteti	2	-	-	1	-	3
Psikologë në Rehabilitim psikologjik	1	-	-	-	-	1
Psikologë Edukimi	-	-	-	1	1	2
Psikologë Zhvillimi	-	-	-	1	1	2
Gjuhesi Klinike					1	
Psikopatologji Klinike					1	

4. Rruga drejt organizimit të Provimit të Shtetit

Me insistimin dhe përkushtimin maksimal, Urdhri i Psikologut, që në fillimin e punës së tij në pak muaj, mundësoi shpërndarjen për herë të parë në Republikën e Shqipërisë të Lejeve Individuale të Ushtrimit të Profesionit të Psikologut (Licencave Profesionale), për të gjithë atë kategori psikologësh, të cilët kishin përfunduar të dy ciklet e studimit përpara hyrjes në fuqi të Ligjit 40/2016, si dhe kishin ushtruar profesionin e psikologut në mënyrë të rregullt përpara hyrjes në fuqi të ligjit, për të paktën 1 vit. Kjo bazuar në legjislacionin dhe aktet në fuqi. Aktualisht, në bazë të vendimit të gjykatës Nr.493 (80-2020-528), datë 17.02.2020, kemi vijuar të shpërndajmë licenca edhe për ata psikologë që kanë përfunduar një cikël studimi në psikologji dhe kanë ushtruar profesionin e psikologut përpara hyrjes në fuqi të ligjit, ndërkohë që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimit pas hyrjes në fuqi të ligjit, pra pas majit 2016.

Në lidhje me organizimin e Provimit të Shtetit për psikologët gjatë këtij viti kemi vijuar të lobojmë dhe kërkojmë intensivisht që të finalizohet sa më parë ky provim. Pas realizimit të disa takimeve me ministren e Arsimit dhe Sportit Znj. Evis Kushi dhe insistimit tonë të vazhdueshëm për përshpejtimin e procesit për organizimin e Provimit të Shtetit për psikologët, nisi puna e grupit të hartuesve të pyetjeve për finalizimin e këtij provimi. Grupi i hartuesve u përzgjodh nga Qendra e Shërbimeve Arsimore, pranë Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë. U përzgjodhën 9 profesionistë me eksperiencë në fusha të ndryshme të psikologjisë, të cilët plotësuan të gjitha kriteret e vendosura nga ana e QSHA-së, për t'u bërë pjesë e këtij grupi.

Detyra e këtij grupi të ngritur pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA) ishte hartimi i programeve orientuese për psikologët dhe hartimi i fondit të pyetjeve për çdo fushë kompetence.

Kemi ndihmuar dhe shtyrë që të procedohej sa më shpejt për nisjen e hartimit të fondit të pyetjeve, duke qenë se aktualisht një numër i lartë psikologësh mbeten në pritje të kryerjes së këtij provimi, për të përfituar licencën profesionale. Ndaj me nisjen e punës për hartimin e fondit të pyetjeve, mbetemi besimplotë se me fillimin e vitit të ardhshëm, ky proces do të finalizohet dhe më në fund do të hapet rruga për realizimin e Provimit të Shtetit për Psikologët.

Në datë 28 Shtator 2021 pas një kohe shumë të gjatë përfundoi puna për përcaktimin e programit orientues mbi të cilin po hartohet fondi i pyetjeve për Provimin e Shtetit për profesionin e psikologut.

Mbetemi në pritje të publikimit të Fondit të Pyetjeve nga ana e grupit të punës pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore në mënyrë që të ndizet drita jeshile për kryerjen e Provimit të Shtetit për Psikologët për herë të parë në vendin tonë.

5. BUXHETI

5.1 TË ARDHURAT

Projekt-Buxheti i vitit 2021 parashikonte mbledhjen e të ardhurave në masën 9,980,000.00 lekë. Duke e krahasuar me buxhetin faktik 2021 kemi nje tejkalim nga mbledhja e të ardhurave nga aktiviteti i kryer në masën rreth 11,116,825.00 lekë.

Blv. Gjergj Fishta, Ndërtesa nr. 26, Kati II, Ap.9,Tiranë,
e-mail: sekretaria@urdhriipsikologut.al, Tel.: 0035542209927

Zërat kryesorë të të ardhurave për vitin fiskal 2021 janë:

- Kuotizacione: rreth 1350 kuotizacione, në total	8,103,195.00 lekë
- Licencime: rreth 81 licencime , në total	1,220,000.00 lekë
- Regjistrime: rreth 409 regjistrime dhe ri-regjistrime, në total	817,525.00 lekë
- Të ardhura nga edukimit në vazhdim, në masën	656,900.00 lekë
- Të ardhura nga botime dhe publikime	10,800.00 lekë
- Të ardhura nga vërtetime anëtarsie	20.400.00 lekë
- Të ardhura nga komisioni i vlerësimit të aftësimit praktik	288.005.00 lekë

Nga sa më sipër është realizuar një total të ardhurash neto të pakufizuara prej rreth 11,116,825.00 lekë. Në përmbyllje të vitit fiskal 2021 zëri i të ardhurave të ligjshme është rritur vit pas viti që nga themelimi i institucionit në vitin 2017.

5.2 SHPENZIMET

Nisur nga eksperienca e viteve të kaluar, për efekt të disiplinimit sa më transparent të të ardhurave, kemi ruajtur një balancë të shpenzimeve të detyrueshme për t'u realizuar sipas planifikimit.

- Paga	**3,761,328.00** lekë
- Shpenzime operative	**6,017,000.00** lekë
- Shpenzimet kapitale	**200,000.00** lekë

Sipas Projekt-Buxhetit të vitit 2021, ishte parashikuar realizimi i shpenzimeve të miratuara sipas zërave si më poshtë:

Shpenzimet për pagat kanë një rritje nga viti paraardhës, pasi për shkak të ndryshimit të ligjit për pagën minimale, paga e punonjësit te IT shkon nga 26000.00 lekë në 30000.00 lekë e pasqyruar në parashikimin nr.3.

Gjithashtu me vendim të Këshillit Kombëtar në muajin maj u realizua një rritje e pagave në masën rreth 21% (bruto), në vlerë 804,672.00 Lekë, më shumë se zëri i pagave i parashikuar në Projekt-Buxhetin e vitit 2021. Nga vlera 3,761,328 lekë shkoi në vlerën 4,566,000 lekë, pasi kjo rritje u konsiderua e përballueshme nga të ardhurat e Urdhrit të Psikologut gjatë vitit fiskal 2021 si dhe u konsiderua një rritje e nevojshme pas 4 viteve punë me qëllim edhe motivimin e stafit të Urdhrit të Psikologut.

Shpenzime buxheti faktik 2021:

Shpenzime për pagat & shpërblimet e punonjësve	4,393,864.00 lekë
- Shpenzime për sigurimet shoqërore & shëndetësore	707,754.00 lekë
- Shpenzime për honorare & personel jashtë njësisë	1,793,529.00 lekë
- Shpenzime për qira zyre	827,200.00 lekë
- Shpenzime administrative të funksionimit	1,303,814.00 lekë
- Shpenzime për aktivitete & marrëdhënie ndërkombëtare	1,018,569.00 lekë
- Shpenzime për printime, publikime dhe manaxhim në web	743,882.00 lekë
- Shpenzime për veprimet bankare e te tjera	62,869.00 lekë
- Shpenzime amortizimi nga inventari i zyrës	97,497.00 lekë
- Shpenzime amortizimi për paisje informatike	38,316.00 lekë
- Shpenzime amortizimi	135,813.00 lekë
- Totali i shpenzimeve faktike	**10,987,294.00 lekë**

Në zërin e **shpenzimeve operative**, janë shpenzuar 3,956,334.00 lekë.

Kjo ka ardhur së pari për shkakun se të ardhurat janë mbledhur mbi masën e parashikuar, çfarë ka mundësuar kryerjen e shpenzimeve të nevojshme të paparashikuara, por që kanë mundësuar aktivitetin normal të U.P. dhe na kanë ndihmuar në arritjen e objektivave.

Gjatë vitit 2021 zëri shpenzime amortizimi kapitale është prekur në masën 135,813.00 lekë, ku llogaritja e amortizimit paraqitet me vlerën e drejtë dhe me pas kjo kosto amortizohet sipas metodes Interesit Efektiv marrë nga (SKK) duke zbritur cdo humbje apo zhvlerësim.

Më poshtë paraqitet e detajuar në zëra një tabelë përmbledhëse e të ardhurave dhe shpenzimeve faktike të vitit fiskal 2021.

Tabela Përmbledhëse e Buxhetit Faktik 2021

Emërtimi	**Vlera**	**Monedha**
	në 000/ lekë	
Të ardhurat:		
Kuotizacionet e anëtarëve	8,103	ALL
Tarifa për regjistrim	817	ALL
Tarifa për licensim	1,220	ALL
Të ardhura nga edukimi ne vazhdim	656	ALL
Të ardhura nga vlerësimi aftësive praktike	288	ALL
Te ardhura të tjera të ligjshme	40	ALL
Rezerva nga viti 2020	932	ALL
Totali	**11,124**	ALL
Shpenzimet:		
Paga	4,393	ALL
Honorare për mbledhjet e UP	1,793	ALL
Shpenzime për sig. shoqërore dhe shënde-tësore	707	ALL
Shpenzimet Operative	3,957	ALL
Shpenzime amortizimi kapitale	135	ALL
Total	**10,985**	ALL
Rezerva për vitin pasardhës	1,071	ALL

Këto shpenzime të kryera janë në vlerat e funksionimit normal të institucionit gjatë një viti pandemik ku shumë aktivitete nuk janë kryer dhe janë anulluar.

Siç shihet, buxheti faktik i vitit 2021 ka ruajtur një balancë të qëndrueshme midis të ardhurave dhe shpenzimeve, duke vijuar ruajtjen e stabilitetit ekonomik të institucionit, si dhe reflekton ambicien për të kaluar në një fazë më të konsoliduar të funksionimit të Urdhrit, me qëllim që aktiviteti i tij të bëhet sa më i ndjeshëm në politikat kombëtare dhe ndërkombëtare, të jetë sa më i prekshëm për anëtarësinë dhe, mbi të gjitha, të përmbushë misionin ligjor për të cilin është krijuar në bazë të ligjit 40/2016 për "Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë".

Blv. Gjergj Fishta, Ndërtesa nr. 26, Kati II, Ap.9,Tiranë,
e-mail: sekretaria@urdhriipsikologut.al, Tel.: 0035542209927

6. OBJEKTIVAT E REALIZUARA GJATË VITIT 2021

- Vijimi i procesit të formalizimit të ushtrimit të profesionit, nëpërmjet rritjes së numrit të psikologëve të regjistruar si anëtarë të Urdhrit.
- Rritja e rolit të Urdhrit të Psikologut në marrëdhëniet ndërkombëtare, nëpërmjet pjesëmarrjes intensive në grupet e punës të EFPA-s.
- Rritja e bashkëpunimit me Shoqatën Europiane të Psikologëve të Punës dhe Organizacionalë (EAWOP), duke synuar përfaqësimin e Shqipërisë në komisionet e përhershme dhe grupet e punës të kësaj organizate dhe duke lobuar për fuqizimin e rolit të psikologut organizacional në Shqipëri.
- Realizimi i provimeve të Vlerësimit të Aftësimit Praktik, si parakusht i pjesëmarrjes në provimin e shtetit.
- Vijimi i ndjekjes së procedurave për realizimin e provimit të parë të shtetit për profesionin e psikologut.
- Ruajtja e bashkëpunimit të ngushtë me pushtetin qëndror dhe lokal, jo vetëm në fuqizimin e rolit të psikologut, por edhe në projekte të përbashkëta në nivel lokal dhe kombëtar, të cilat kanë faktorizuar punën e psikologut në terren.
- Vazhdimi i zgjerimit të rrjetit të koordinatorëve lokalë.
- Standardizimi i punës së psikologut në polici.
- Përmirësimi i sistemit të Edukimit në Vazhdim në psikologji, me qëllim rritjen e efektivitetit të tij.
- Shtimi i aktiviteteve të edukimit në vazhdim, që mundëson marrjen e krediteve nga psikologët, të nevojshme në procesin e rilicencimit.
- Ruajtja e qëndrueshmërisë së institucionit dhe mbarëvajtja e aktivitetit.

7. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2022

Objektivat që institucioni ynë synon të realizojë përgjatë vitit 2022 janë:

- Vazhdimi i procesit të formalizimit të ushtrimit të profesionit, nëpërmjet rritjes së numrit të psikologëve të regjistruar si anëtarë të Urdhrit.
- Realizimi në vazhdimësi i provimeve të Vlerësimit të Aftësimit Praktik, si parakusht i pjesëmarrjes në provimin e shtetit.
- Vijimi i ndjekjes së procedurave për realizimin e provimit të parë të shtetit për profesionin e psikologut dhe realizimi i Provimit të Shtetit.
- Fuqizimi i rolit të psikologut në fushën e Drejtësisë dhe ofrimi i trajnimeve të vazhdueshme për këtë kategori psikologësh.
- Fuqizimi nëpërmjet informimit dhe ndërgjegjësimit të psikologëve, në lidhje me ushtrimin e profesionit të psikologut brenda fushave të tyre të kompetencës.
- Vazhdimi i zgjerimit të rrjetit të koordinatorëve lokalë.
- Organizimi, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar dhe vendas, i cikleve të trajnimeve, me qëllim formimin e psikologëve të specializuar për ndërhyrje në situata dhe problematika të caktuara.
- Rritja e bashkëpunimit me Federatën Europiane të Psikologëve me qëllim rritjen e standardeve profesionale.
- Rritja e bashkëpunimit me Shoqatën Europiane të Psikologëve të Punës dhe Organizacionalë (EAWOP), duke synuar përfaqësimin e Shqipërisë në komisionit e përhershme dhe grupet e punës të kësaj organizate.
- Sensibilizimi dhe fuqizimi i rolit të psikologut organizacional dhe ndërmarrja e nismave për aplikimin në vend të psikologjisë organizacionale në institucione publike dhe private.
- Marrja e statusit të vendit anëtar me të drejta të plota në Unionin Ndërkombëtar të Shkencës së Psikologjisë (International Union of Psychological Science - IUPsyS), si një nga organizatat më të rëndësishme botërore në fushën e psikologjisë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

28 JANAR 2017

URDHRI I PSIKOLOGUT